


Përditësimi i Javës Globale të Lutjes



Për 29 vjet, Misionet Ndërkombëtare Nazaretase kanë ftuar Kishën e Nazaretasit për të marrë pjesë në Javën Globale të Lutjes. Çdo vit, javën që përfshin të Premten e parë të Marsit (e caktuar si Dita Botërore e Lutjes), Nazaretasit anembanë botës udhëhiqen përmes pikave të lutjeve dhe lavdërimit nga secili prej gjashtë rajoneve të botës.

Pjesëmarrja globale vazhdon të rritet çdo vit. Fokusi i Javës Globale të Lutjes është të bashkojë Kishën në ngritjen e punës së misioneve kudo. Ne lutemi për kërkesa specifike nga çdo rajon dhe bashkohemi në lavdërim për gjithçka që Perëndia po bën në çdo rajon. Edhe këtë vit, janë përgatitur materiale që përfshijnë fëmijët në Javën Globale të Lutjes.

Një Shikim i Shpejtë MNN



Këto burime për Javën Globale të Lutjes 2025 janë të disponueshme në formate dixhitale dhe të printuara, në 20+ gjuhë dhe mund të shkarkohen nga www.nazarene.org/nmigwp. Këto burime mund të përdoren gjatë gjithë vitit për të ndihmuar në fokusimin e lutjes dhe lavdërimit, si individualisht ashtu edhe në shoqëri.

Përveç kësaj, ekziston një Video e Numërimit Mbrapsht që është përgatitur për të ndihmuar në promovimin e pjesëmarrjes në Javën Globale të Lutjes të këtij viti. Për këtë video, klikoni [këtu](#).



Java Globale e Lutjes 2025 do të zhvillohet nga e Diela e 2 Marsit deri të Shtunën, 8 Mars 2025. Shënoni këto data në kalendarin tuaj dhe bashkohuni me Nazaretasit kudo në lutje dhe lavdërime.

Nuk do të ketë një material nga MNN-ja Qëndrore javën e ardhshme, e Mërkurë, 5 Mars, sepse pjesmarrësit do të marrin emaile të përditshme në adresat e tyre që lidhen posaçërisht me Javën Globale të Lutjes. Ne do të kthehemi sërish në materialin e MNN-së Qëndrore dhe formatin e rregullt të saj javën e ardhshme, më 12 Mars.

[A mund të shërbeni?](#)

Si po përgjigjeni ndaj nxitjeve të Perëndisë për tu lutur për misionet?
Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

MNN Qendrore është e disponueshme në një arkiv në formatin PDF.

Për të lexuar botimet e mëparshme, klikoni [këtu](#).



17001 Prairie Star Pkwy
Lenexa, KS | 66220 US



KISHA e
NAZARENIT